

POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

Protestuesja nga tubimi para Kryeministrit: Sali Berisha vrau bijtë e nënave në 1997-ën, hapi depot dhe shiti armët!

LIVE TV: Pas dhunës të konsideratit m.3, mbliiden përsëri protestuesit, organizatori Kola: Ne s'kemi sulmuar, 'maskat' janë të sponsorizuar nga qeveria

Qytetarja kërkesë të veçantë kryeministrit Rama nga protesta: Mjaft! U ulë në gjunjë

Ben Andoni: Është vonë...

Arkivoli në protestë, Berisha në mbështetje të akteve të dhunshme: Do të qëndrojmë krah protestuesve deri në fund, kërkesat e tyre janë edhe të PD-së (VIDEO)

Kronikë

Operacioni me DIA-n e Barit, SPAK zbardh si u prangos Adi Çoba nga BKH në Shkozet, iu gjet armë me vete! U kap në bastionin e grupit kriminal Troplini-Doçi

Adi Çoba, i dyshuar si organizator dhe drejtues i një grupi kriminal të trafikut të drogës, i goditur nga operacioni "Ura", u arrestua mbrëmjen e së mërkurës, falë një operacioni të përbashkët të SPAK, me Drejtorinë e Antimafias së Barit. Prokuroria e Posaçme njoftoi këtë të premte se ai u gjet në lagjen e tij në Shkozet, lokalitet i cili përshkruhet si qendra kryesore e grupit kriminal Troplini-Doçi, që vepronte mes Puglia-s, Shqipërisë dhe Holandës.

- Adi Çoba u prangos te dera e shtëpisë në Durrës! BKH s'e njoftoi policinë, e survjeoi 3 ditë
- BKH arrestime pa Policinë e Shtetit? Ministri Lamallari: Ligji i jep të drejtën të ekzekutojë masat e sigurisë

REPORT TV

Operacioni me DIA-n e Barit, SPAK zbardh si u prangos Adi Çoba nga B

Report TV

Watch on

Redaksia

3 Korrik, 17:37 | Përditësimi: 3 Korrik, 23:51


Share

Post

Adi Çoba ishte një ndër emrat e rëndësishëm të cilët i shpëtuan arrestimit gjatë operacionit të përbashkët mes autoriteteve shqiptare, italiane e belge, me emrin e koduar "Ura" i zhvilluar më 21 maj të vitit të kaluar.

Në 13 muajt që pasuan, duke shijuar lirinë, përpjekjet për arrestimin e tij, nuk kishin reshtur.

"SPAK dhe autoritetet italiane i shtrinë hetimet në Durrës dhe në disa qytete në veri dhe jug të Italisë duke bërë të mundur lokalizimin e tij".



LEXO EDHË: Itali/ Shpërthen sërish vullkani Etna në Sicili, kufizime në fluturime në aeroportin e Katanias

Çoba, i cili sipas burimeve po survejohej nga afër prej të paktën tre ditësh para arrestimit, ishte lokalizuar në Shkozet, një lokalitet, i cili sipas Prokurorisë së Posaçme është qendra kryesore e grupit kriminal Troplini-Doçi, me një veprimtari të shtrirë mes Puglia-s, Shqipërisë dhe Holandës, u lokalizua në lagjen e tij.

Adi Çoba konsiderohet si një bashkëpunëtor i ngushtë i Ervis Doçi, i njohur ndryshe si "Visi i Pojës", ende në kërkim.

Në momentin e arrestimit, atij iu gjet një pistoletë automatike me dy karikatorë si dhe katër dokumente të falsifikuara, mes të cilëve një kartë identiteti dhe patente italiane. Pikërisht këto dokumenta, tregojnë sipas Prokurorisë së Posaçme, "lëvizjen e shpeshtë si dhe lidhjen me Italinë", drejt së cilës ai pritet tanimë të ekstradohet.

Operacioni për arrestimin e tij u organizua dhe ekzekutua nga vetë agjentët e BKH, duke shmangur në këtë mënyrë përfshirjen e Policisë. Në të njetën ditë, në parlament kreu i SPAK, Klodian Braho kishte paralajmëruar se institucioni që ai drejton po sheh si alternativë që të mund të realizojë vetë kapjen e personave të shpallur në kërkim, teksa e theksonte se nuk e kuptonte pse disa nuk arrestohen.

Vitin e kaluar, operacioni "Ura", u vlerësua si një nga goditjet më të suksesshme, duke çuar në dhjetëra arrestime, kryesisht në Itali, dhe shkatërrimin e një prej grupeve më të fuqishme kriminale në Durrës dhe 2 nëngrupeve të tjera me qendër në Bari, të përfshira në trafikun ndërkombëtar të drogës në Evropë e deri në Amerikën Latine.

R.Xh/E.H/Shqiptarja.com

TAG: 

spak

Durres

adi çoba

trafik droge

BKH

itali

Komento

Komente

Cncn:

03/07/2026 17:55

Askund se thone "gjate prangosjes".

Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:

3 Korrik, 10:41

Sipas jush, protesta te Kuvendi a ka qenë e dhunshme nga ana e protestuesve?

Po

Jo

Nuk e di

Lajme të tjera

Kapet me minë me telekomandë në makinë, arrestohet 38-vjeçari në Vaun e Dejës, në kërkim bashkëpunëtori (VIDEO)

5 Korrik, 14:40

Samiti i NATO-s, Meloni paralajmëron: Mos e lini të shndërron në një shfaqje të Trumpit

5 Korrik, 11:15

'Klithma mesdhetare' në Durrës, shfaqje për dramën e emigrantëve

4 Korrik, 14:29

Papa lutet në varrezat e emigrantëve në Lampedusa! Ati Shenjtë vendos lule, kalon Portën e Evropës dhe ecën i vetëm mbi shkëmbinj

4 Korrik, 10:38

Vilant Xhori: Makijazhi ndreqet, por kriza mbetet

3 Korrik, 16:11

Kërkesë të re për arrestimin e Ballukut? Bardhi-Brahos: Mos prit arratisjen! Po bën politikë sipas interesave të Ramës

3 Korrik, 14:47

Protesta duhet të përbuzë çdo koncept për Vetëgjyqësi!

3 Korrik, 10:52

SPAK tjetër kërkesë për arrestimin e Ballukut? Braho: Vendim bazuar në provat e reja, imuniteti nuk pengon zhvillimin e hetimeve të plota! Presim më shumë nga Policia

3 Korrik, 10:21

Kapiteneria e Portit të Durrësit koordinon operacionin në det të hapur, i vjen në ndihmë jahtit 'Infinity Nine'

3 Korrik, 07:54

Operacionalja e BKH-së zbret në terren, 25 të kërkuar në listë

2 Korrik, 12:16

'Pastruan 30 mln euro', SPAK mbyll hetimet për inceneratorin e Tiranës! Në gjykim 12 persona! Inceneratori arkëtoi 120 mln €, u investuan vetëm 21 mln

2 Korrik, 10:56

Drejtonte rrjetin e trafikut të kokainës në Itali, Adi Çoba u prangos te dera e shtëpisë në Durrës! BKH s'e njoftoi policinë, e survjeoi 3 ditë

2 Korrik, 09:28